

Shërbim klienti

Pozicioni:

Ky rol është përgjegjës për ofrimin e një shërbimi të kualifikuar cash dhe jo-cash në përputhje me standardet e përcaktuara të Bankës, duke identifikuar, analizuar dhe trajtuar me profesionalizëm nevojat e klientëve për t'i konvertuar ato në shitje dhe për të arritur objektivat e vendosura nga menaxherët.

Detyrat kryesore

- Të jetë njohës i mirë i produkteve të katalogut që ofron banka dhe t'i përshtatë ato sipas nevojave të klientëve;
- Të kryejë transaksionet cash për të gjithë segmentet e klientëve;
- Të diskutojë dhe pranojë aplikime për Çeljen e Llogarisë, Paketa, Pagesa, Direct Debit, Pagesa Periodike, Çeku, Bono Thesari, Kartë Debiti, RON, Depozita, Produkte Sigurimi, Plane Investimi etj., dhe të sigurohet që të gjitha të dhënat e marra nga klientët janë në përputhshmëri me politikat dhe direktivat e bankës;
- Të kryejë në sistemet/aplikacionet e bankës veprimet jo-cash duke aplikuar të gjitha procedurat operacionale të bankës që lidhen me detyrën e tij/saj;
- Të procesojë vlerat monetare në përputhje me procedurat e Bankës së Shqipërisë dhe procedurat e RBAL.

Kërkesat për kandidatët: Përvoja & Aftësitë

- Diplomë Bachelor në Administrim, Financa, Marketing;
- Aftësi shumë të mira komunikuese;
- Aftësi shumë të mira për të punuar në grup;
- Aftësi për t'u adaptuar shpejt ndaj ndryshimeve;
- Aftësi të mira analitike.

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë në recruitment.hr@raiffeisen.al.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të njoftohen.

Raiffeisen Bank dëshiron t'u vërë në vëmendje kandidatëve të interesuar se çdo informacion që do të paraqesin lidhur me shprehjen e interesit të tyre për sa më sipër do të trajtohet me një nivel sigurie në përputhje të plotë me parashikimet e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Gjithashtu, me dhënien e këtij informacioni, kandidati i interesuar deklaron dhe jep miratimin e tij për përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale nga ana e Raiffeisen Bank, vetëm për përdorim të brendshëm të Bankës dhe vetëm për qëllimin për të cilin ai ka deklaruar vullnetarisht këto të dhëna.